

mission

UPDATE

Qershor / Korrik / Gusht 2015

*"FIQ beson, se filozofia e cdo politike apo
veprimi duhet të reflektojë pikëpamjet e njerëzve
të Kosovës, për të formësuar marrëdhëniet
qytetarë – shtet"*

Dhuro pemën tënde – Jepi jetë një komuniteti



Në kuadër të “Javës së Energjisë së Qëndrueshme”, Forumi për Iniciativa Qytetare, organizoi në Obiliq dhe Shkabaj kampanjën “Dhuro pemën tënde – Jepi jetë një komuniteti”.

Kampanja “Dhuro pemën tënde – Jepi jetë një komuniteti”, qëllimin kryesor e kishte promovimin e mjedisit të shëndetshëm për qytetarët e rajonit të Obiliqit dhe ofrimin e mbështetjes simbolike, veçanërisht për komunitetin e zhvendosur në Hade të Re/Shkabaj. Lulet e mbjella ishin të gjitha dhurim i individëve, bizneseve, institucioneve publike dhe organizatave të shoqërisë civile.

Kampanja për mbledhje fondesh do të vazhdoj deri në fund të muajit Shtator, dhe ato para të mbledhura do përdoren për blerjen e pemëve dhe drunjëve të cilat do të mbillen në muajin Tetor 2015.

Tre kontribuuesit më të mëdhenj të kësaj

kampanje ishin:

Banka KEP;

Lulishte “Parajsa”

dhe Komuna e Obiliqit /KI/





FIQ promovon inovacionin, rëndësinë e ekonomisë së gjelbërt nëpërmjet organizimit për çdo vit të garës rajonale për ide të gjelbëra dhe inovative

Më datë 04 Qershor 2015 në kuadër të konkursit “Ide Biznesi - Të Gjelbërta dhe Inovative 2015” të organizuar për të tretën herë radhazi nga Forumi për Iniciativa Qytetare, komisioni përzgjedhës, i përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme, ka përzgjedhur 3 idetë fituese të garës kombëtare. Diversiteti dhe inovacioni i projekt ideve, mbështetur nga serioziteti dhe profesionalizmi i finalistëve ishte një vlerë e shtuar e këtij konkursi.

Te tre fituesve për Ide Biznesi të Gjelbërta dhe Inovative 2015 ju dhanë mjetet në vlerë prej 2500 € për secilin nga tre fituesit nga Robert Wright drejtor ekzekutiv i [Raiffeisen Bank Kosovo](#), si partnerë të FIQ-it në kuadër të këtij projekti.

Forum i Iniciativës Qytetare falenderon Raiffeisen BANK për mbështetjen e 3 fituesve të Ideve të Gjelbërta e Inovative 2015 FIQ i uron fituesit që idetë e tyre të kontribojnë në zhvillim ekonomik, social dhe mjedisor të vendit.



Tre fituesit për Ide Biznesi të Gjelbëra dhe Inovative 2015


o Havushe Bajrami-Bunjaku - “99 Lule”

Eshtë një biznes social. Mbledhja dhe kultivimi i mbi 20 llojë të bimëve nga gratë kryefamiljare që vijnë nga familje me asistencë sociale.



o Rron Ceka – “Formon”

Krijim inovativ i printerit 3D, ku në vend të plastikës klasike të rrezikshme dhe të dëmshme për ambientin, përdorë si lëndë të parë plastikën biodegraduese e fituar nga përzierja e niseshtes së grurit dhe patates.



o Ymer Dullaj – “EkoFerma”

Krijimi i një modeli të suksesshëm për fermat në gjithë Kosovën me qëllim kursimin e energjisë elektrike, mbrojtjen e ambientit dhe rritjen e të ardhurave nëpërmjet përdorimit të biogazit që prodhohet nga mbejtet e pulave, si energji alternative.



FIQ merr pjesë në ciklin e dytë të “AKADEMIA PER QENDRUSHMERI”



- o Akademia per qendrueshmeri eshte nje program trajnimesh ku nepermjet te ciles organizatat e shoqerise civile marrin njohuri si te sigurojne qendrueshmeri financiare. Akademia mbeshtet organizatat me njohuri te mjaftueshme per tu perfshire ne procesin e ngritjes se fondeve ne komunitetin perreth tyre me nje nocion te qarte qe planifikimi strategjik permban nje lidhje logjike me ngritjen e fondeve.

FIQ nënshkruan kontratat me OJQ- të për projektin e SIGN

- o FIQ nënshkroi kontratat me organizatat që ka përzgjedhur në kuadër të projektit SIGN për Qëndrueshmëri. Kontratat e nënshkruara pasqyrojnë grantin teknik për 5 organizata në vlera nga 1000€ për organizatë, grant ky që OJQ-të do ta shfrytëzojnë për ngritjen e fondeve. Qëllimi i këtij projekti është të ngrisim kapacitetet e OJQ-ve në ngritjen e fondeve bazuar në donatorë të ndryshëm, kryesisht lokalë. SIGN për Qëndrueshmëri është një nismë rajonale, që financohet nga Komisioni European.



FIQ me NDI mbeshtet EKOSOVA nje nisme e dale prej Akademise se Grave per Lidership, program i organizuar prej NDI dhe USAID

EKOsova është fokusuar në trajtimin e çështjeve të mjedisit, më saktësisht në këtë projekt trajton Taksat e ambientit. Interesimi për tu marrë me fushën e ambientit ka ardhur si rezultat i sfidave dhe problemeve të shumta me të cilat përballemi çdo ditë. Problemi i ndotjes së ajrit është shumë aktual në Kosovë, duke pasur parasysh gjendjen e vjetruar të termocentraleve A dhe B, si dhe mundësinë e investimit në një termocentral të ri me thëngjill.

Organizatrat me fonde te ndryshme, te cilat jane ne pozicionin per te perfshire qytetaret, do te jene ato organizata qe marrin me teper mbeshtetje nga niveli lokal dhe qendror dhe sigurojne rritje te nivelit te perfshirjes se qytetareve dhe mobilizimin e burimeve lokale.



Forumi për Iniciativ a Qytetare

Lagja Pejton, Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku
20, nr. 3
10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 248 677
www.fiq-fci.org

Na ndiqni edhe në:

